

**VENDIM**  
**Nr. 453, datë 26.7.2023**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 16.1.2019, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E SHOQËRIVE TË TJERA  
SHTETËRORE OSE PRIVATE, TË RËNDËSISHME PËR INTERESIN E  
PUBLIKUT, PËR SHKAK TË NATYRËS SË BIZNESIT, MADHËSISË OSE  
NUMRIT TË PUNËMARRËSVE TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të pikës 23, të nenit 2, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 17, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në nënndarjen III, “Klasifikimi për shkak të madhësisë së biznesit”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “a”, vlera “1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë) lekë” zëvendësohet me “2 500 000 000 (dy miliardë e pesëqind milionë) lekë”;

b) Në shkronjën “b”, vlera “750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lekë” zëvendësohet me “1 250 000 000 (një miliard e dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë”;

c) Në shkronjën “c”, fjalët “... të kësaj pike ...” zëvendësohen me “... të kësaj nënndarjeje ...”.

2. Shkronja “a”, e nënndarjes IV, “Klasifikimi për shkak të numrit të punëmarrësve të tyre”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**